



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



L I C E N C Ě E S H Ě R B I M I T

E L Ě S H U A R P Ě R:

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT "HIDROREGJIONI JUGOR"
SH.A. PRIZREN

tetor 2012

LICENCË E SHËRBIMIT

1. Përkufizimet dhe Interpretimet

- 1.1. Në këtë licencë të shërbimit, fjalët dhe shprehjet e shkruara në fontin *italik*, do ta kenë kuptimin ashtu siç është përkufizuar në shtojcën 1 të kësaj licence të shërbimit, ose në Rregullën për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë, të datës 28 tetor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregulla - R01/U&K).
- 1.2. Interpretimi i kësaj licence të shërbimit do të bëhet në pajtim me rregullat vijuese:
- Fjalët që paraqesin një rën gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;
 - Fjalët që paraqesin njëjës do të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas;
 - Referenca në pjesë, klauzola, apo shtojca nënkupton pjesët, klauzolat apo shtojcat e kësaj licence të shërbimit;
 - Titujt janë vendosur për përdorim më të përshtatshëm dhe nuk kanë ndikim në interpretimin e kësaj licence të shërbimit;
 - Referencat në një ligj, rregull të nxjerrë nga ZRRUK, udhëzim administrativ, urdhëresë tarifore, kartë të konsumatorëve, certifikatë të licencës së shërbimit, apo ndonjë dokument tjetër, iu referohen atij ligji, rregulle, udhëzimi administrativ, urdhërese tarifore, karte të konsumatorëve apo dokumenti tjetër bashkë me ndryshimet, plotësimet, apo zëvendësimet që iu bëhen atyre kohë pas kohe.

2. Lëshimi i Licencës së Shërbimit

- 2.1 *Rregullatori* e lëshon këtë licencë të shërbimit për të *licencuarin* në pajtim me Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturisë (në tekstin e mëtutjeshëm: *Ligji Nr. 03/L-086*) i të datës 13 qershor 2008. .
- 2.2 *I Licencuari* duhet të ofrojë *shërbimet* në tërë *zonën e shërbimit* në pajtim me kushtet dhe dispozitat e përcaktuara në këtë licencë të shërbimit.

3. Afati i Licencës së Shërbimit

Afati i vlefshmërisë së kësaj licence të shërbimit fillon në datën e lëshimit dhe vazhdon deri:

- në datën e revokimit nga *Rregullatori* në pajtim me *Ligjin Nr. 03/L-086*;
- në datën e dorëzimit nga *i licencuari* në pajtim me *Ligjin Nr. 03/L-086*;
- më 31 tetor 2015

4. Zona e Shërbimit

Zona e shërbimit në të cilën i licencuari është i autorizuar të ofrojë shërbimet përfshinë komunat: Prizren, Suharek, Malishev, Dreagash dhe Mamush.

5. Obligimet e të Licencuarit

5.1 *I licencuari* është i obliguar që gjatë tërë afatit të vlefshmërisë së licencës së shërbimit të jetë në pajtim me:

- a) *Ligjin*;
- b) Rregullat e nxjerra nga *Rregullatori* në pajtim me Nenin 38 të Ligjit Nr 03/L-086;
- c) Vendimet e *Rregullatorit* të marra në pajtim me Nenin 38 të Ligjit Nr.03/L-086;
- d) Këtë *licencë të shërbimit*;
- e) *Kartën e Konsumatorëve*;
- f) *Kontratat e Shërbimit*;
- g) *Marrëveshjet e Shërbimit* me komunat;
- h) Ligjet e aplikueshme mjedisore;
- i) Kërkesat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publike të Kosovës;
- j) Licencat, lejet, dhe kërkesat tjera nga institucionet përkatëse në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

5.2 *I licencuari* është i obligueshëm ti paguajë *Rregullatorit* taksat rregullore në pajtim me nenin 8 të Ligjit Nr 03/L-086.

5.3 *I licencuari* është i obligueshëm të faturojë konsumatorët e tij me *tarifat e shërbimit* të aprovuara nga *Rregullatori* në pajtim me *Ligjin Nr.03/L-086*.

5.4 *I licencuari* është i obligueshëm që të përgatisë dhe të dorëzojë tek *Rregullatori* raporte në formën dhe intervalet e përcaktuara në Rregullat e nxjerra nga *Rregullatori*, të plotësuara dhe të ndryshuara kohë pas kohe.

5.5 *I licencuari* është i obligueshëm që gjatë tërë kohës së vlefshmërisë së licencës së shërbimit të mirëmbajë kapacitetet financiare, teknike, operative, dhe menaxheriale të nevojshme për ofrimin e *shërbimeve* në nivel të standardeve minimale të shërbimit pajtim me *Ligjin Nr03/L-086* dhe Rregullat e nxjerra nga *Rregullatori*.

6. Përtëritja e Licencës së Shërbimit:

Kjo licencë e shërbimit mund të përtëritet nga *Rregullatori* me kërkesë të *licencuarit* në pajtim me Ligjin Nr 03/L-086 dhe Rregullën R01/U&K.

7. Transferimi i Licencës së Shërbimit

Kjo licencë e shërbimit nuk mund ti transferohet ndonjë pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim nga *Rregullatori*, në pajtim me Rregullën R01/U&K.

8. Ndryshimi, Plotësimi dhe Zëvendësimi i Licencës së Shërbimit

Kjo licencë e shërbimit mund të ndryshohet, plotësohet dhe zëvendësohet nga *Rregullatori* në pajtim me *Ligjin Nr.03/L-086* dhe Rregullën R01/U&K.

9. Masat Administrative

Në rast se *i licencuari* bën shkelje të *Ligjit Nr.03/L-086*, Rregullave të nxjerra nga *Rregullatori* apo kushteve të kësaj licence të shërbimit, *Rregullatori* mund të shqiptojë masa sanksionuese administrative në pajtim me nenin 32 të *Ligjit Nr. 03/L-086*.

10. Të Ndryshme

- 10.1. Në rast të ndonjë mospërputhje në mes versioneve gjuhësore të kësaj licence të shërbimit, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- 10.2. Nëse dispozitat dhe kushtet e kësaj licence të shërbimit janë në papajtueshmëri me dispozitat dhe kushtet e Kontratës për Shërbime, Kartës së Konsumatorëve, Marrëveshjes për Shërbime, atëherë dispozitat dhe kushtet e parapara me këtë licencë të shërbimit do të kenë përparësi.
- 10.3. Çertifikata e licencës së shërbimit dhe Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj licence të shërbimit.
- 10.4. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence të shërbimit është përcaktuar nga autoriteti kompetent si i pavlefshëm (zbrazët) ose i pazbatueshëm për çfarëdo arsye, atëherë ajo dispozitë do të largohet dhe dispozitat e mbetura do ta vazhdojnë të jenë në fuqi dhe me efekt të plotë.
- 10.5. Asnjë heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave apo kushteve të kësaj licence të shërbimit nga ana e *Rregullatorit* nuk do të ketë efekt nëse ato nuk i ofrohen të *licencuarit* në formë të shkruar. Dështimi për të zbatuar cilëndo dispozitë apo kusht të kësaj licence të shërbimit nga ana e *Rregullatorit* nuk përbën heqje dorë nga ajo dispozitë apo kusht dhe nuk do të paragjykojë të drejtën e *Rregullatorit* për të zbatuar ato më vonë.

Shtojca 1: Përkufizimet

Në këtë licencë të shërbimit janë të aplikueshme përkufizimet si vijon:

Çertifikatë e Licencës së Shërbimit nënkupton çertifikatën aktuale të licencës së shërbimit të lëshuar nga Rregullatori e cila është pjesë përbërëse e licencës së shërbimit;

I licencuari nënkupton Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh. A.-Prizren;

Karta e Konsumatorëve nënkupton dokumentin e nxjerr nga i licencuari në pajtim me Rregullën për Kartën e Konsumatorëve për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë (referenca Rregullorja-R04/U&K) të miratuar nga Rregullatori;

Komunat nënkupton komunat të cilat janë themeluar në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave Nr.03/L-041;

Konsumator nënkupton çdo person që ka lidhë kontratë të shërbimit me të licencuarin ose që ka pranuar shërbime të ofruara nga i licencuari;

Kontratë e Shërbimit nënkupton kontratën standarde për ofrimin e shërbimeve në formën e aprovuar nga Rregullatori, e cila lidhet në mes të licencuarit dhe konsumatorëve të tij;

Ligji Nr.03/L-086 nënkupton *Ligjin mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave;*

Marrëveshje e Shërbimit nënkupton marrëveshjen e lidhur mes Komunës dhe të licencuarit nën mbikëqyrjen e Rregullatorit në të cilën janë përcaktuar të drejtat dhe obligimet e të dy palëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve;

Rregullator nënkupton Zyrën Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim e themeluar me nenin 1.2 të *Ligjit Nr.03/L-086;*

Shërbimet nënkupton:

- a) Shërbimet e Ujësjellësit, dhe
- b) Shërbimet e Kanalizimit.

Shërbimet e Ujësjellësit nënkupton grumbullimin, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit për tu konsumuar nga njerëzit dhe funksionimi i rrjetit dhe pajisjeve që përdoren për këtë qëllim;

Shërbimet e Kanalizimit nënkupton grumbullimi, trajtimin dhe shkarkimin e ujit të përdorur dhe i ujërave të zeza;

Tarifat e Shërbimit nënkupton çmimet në fuqi të të licencuarit të aprovuara nga Rregullatori me të cilat faturohen konsumatorët për shërbimet e ofruara.

Shtojca 2: Kushtet plotësuese

1. *I licencuari*, në pajtim me nenin 56.1 pika a) dhe b) të *Ligjit për Ujërat e Kosovës Nr. 2004/24* dhe nenin 5.1 pika e) të *Ligjit Nr.03/L-086*, obligohet që në afatin prej 6 muajve nga data e lëshimit të kësaj *Licence të Shërbimit të sigurojë lejen për nxjerjen e ujit dhe lejet për shkarkimin e ujërave të ndotura. Monitorimi i këtij kushti do të bëhet nga Departamenti për Ligjit dhe Licenca të Rregullatorit;*
2. *I licencuari*, në pajtim me nenin 6.1 pika b) të *Ligjit Nr.03/L-086*, nenit 30 të R01/U&K *obligohet që të siguroj qëndrueshmëri financiare vit pas viti*. Monitorimi i këtij kushti do të bëhet nga Departamenti për Tarifa dhe Financa Rregullatore të ZRRUK përmes raporteve analizave dhe inspektiveve.